



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:067016

Datë: 04.11.2019

Numri i dokumentit: 00624562

P.nr.507/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. G. nga fshati K. e U. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2848-7/2018, të datës 14.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Pokurorit të Shtetit Naim G. dhe të akuzuarit H. G., me datë 31.10.2019 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datën 04.11.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. G., nga i ati H. dhe e ëma H. G. e vajzërisë S., i lindur me, në fshatin K. e U. Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, me numër personal, nr. unik DPZ 9067293, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i 8 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë veprë penale, mbrohet nga liria.

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri me datë 07.08.2018, në fshatin D. e U. komuna Suharekë, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte jashtë njuhësorit elektrik, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar "KEDS", Departamenti ligjor në Prizren i ka shkatuar dëm material.

Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 2 (dy) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

I akuzuari lirohet prej shpenzimeve të procedurës konform nenit 453 par.4 të KPP-së.

E dëmtuara “KEDS” Departamenti ligjor në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 2848-7/2018, të datës 14.11.2018 kundër të akuzuarit vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Naim G., i njëjti bënë rikualifikimin e veprës penale konform nenit 3 të KP-së, për aplikimin e dispozitave më të favorshme për të akuzuarin nga vepra penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, ku i akuzuari ka theksuar se e ka kuptuar në tërësi akuzën dhe e ka pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit, nga shikimi dhe leximi i procesverbalit të KEDS nr.0897742 të datës 07.08.2018, fatura DPZHP1813404 të dt.18.09.2018, fotodokumentacion si dhe shkresave tjera të lëndës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi se i njëjti është i pa dënuar më parë, rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimi për lirimin e të akuzuarit për shpenzimet e procedurës është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË P.nr.507/2018 të dt. 04.11.2019

**Bashk.Profesional
Feim Bytyqi**

**Gjyqtari
Qemail Suka**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.